



UNIVERSITETI I MITROVICËS "ISA BOLETINI" UNIVERSITY OF MITROVICA "ISA BOLETINI"

PLANI VJETOR I PUNËS SË KOMISIONIT QENDROR PËR SIGURIM TË CILËSISË DHE VLERËSIM (KQSCV)

Komisioni qendror për sigurim të cilësisë dhe vlerësim (KQSCV) është organ këshillëdhënës i Senatit. Kompetencat e tij janë: të hartojë udhëzuesin e aktiviteteve të vlerësimit të sigurimit të cilësisë, të hartojë instrumentet për vlerësim kualitativ dhe kuantitativ, të hartojë dhe shqyrtojë raportet e vlerësimit/vetëvlerësimit, të shqyrtojë raportet e vetëvlerësimit për akreditim institucional dhe të programeve, të shqyrtojë raportet e vetëvlerësimit për riakreditim institucional dhe të programeve në lidhje me nivelin e adresimit të çështjeve të ngritura nga AKA, të miratojë anëtarët e grupeve punuese për realizimin e vlerësimeve sipas nevojës si dhe të udhëheqë procesin e publikimit të raporteve vlerësuese.

Bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë e KQSCV në tabelën mëposhtë po i listojmë aktivitetet nga të cilat përbëhet plani i punës së këtij komisioni.

Nr.	Bartësi i Aktivitetit	Aktiviteti (Detyrat e planifikuara)	Periudha kohore	Implikimi financiar	Ndërlidhja	Të tjera
1	KQSCV	Hartimi i Rregullores së punës së Komisionit	Tetor - Nëntor 2020	Po	ZSC, ZZHA, Njësitë akademike	
2	KQSCV	Takimet e rregullta	Dy herë në muaj	Po	ZSC, Njësitë akademike	Takimet mund të zhvillohen edhe më shpesh varësisht prej volumit të punëve
3	KQSCV	Shqyrtimi i RVV të programeve të studimit që janë në procedurë të akreditimit/riakreditimit	Nëntor - Dhjetor 2020	Po	ZSC, Njësitë akademike	Varësisht prej kohëzgjatjes së procesit të akreditimit/r i-akreditimit
4	KQSCV	Trajnimi i stafit administrativ për ECTS	Dhjetor 2020	Po	ZSC, Njësitë akademike,	



UNIVERSITETI I MITROVICËS "ISA BOLETINI"
UNIVERSITY OF MITROVICA "ISA BOLETINI"

Nr.	Bartësi i Aktivitetit	Aktiviteti (Detyrat e planifikuara)	Periudha kohore	Implikimi financiar	Ndërlidhja	Të tjera
					Stafi administrativ	
5	KQSCV	Pyetësi për vlerësimin e studentëve Bachelor për stafin akademik dhe lëndët. Pyetësi për vlerësimin e studentëve Master për stafin akademik dhe lëndët.	Dhjetor 2020	Po	ZSC, Koordinatorë t për cilësi, Stafi akademik, Studentët	Realizohen në Janar 05.01.2021 - 15.01.2021
6	KQSCV	Trajnimi i stafit akademik për ECTS	Janar - Shkurt 2021	Po	ZSC, Njësitë akademike, Stafi akademik	
7	KQSCV	Hartimi dhe aprovimi i pyetësoreve	Janar – Maj 2021	Po	ZSC, Njësitë akademike, Palët e Interesit, Alumni	
8	KQSCV	Shqyrtimi i riformulimit të pyetësorëve të hartuar	Në fund të çdo semestri	Po	ZSC, Njësitë akademike, Palët e Interesit, Alumni	
9	KQSCV	Plotësim-ndryshimi i rregullores së sigurimit të cilësisë dhe vlerësimin në UMIB	Shkurt - Mars 2021	Po	ZSC, Njësitë akademike, Sekretari i UMIB, ZLGJ	
10	KQSCV	Pyetësi për vlerësimin e stafit akademik për shërbimet mbështetëse në UMIB Pyetësi për vlerësimin e studentëve për shërbimet mbështetëse në UMIB Pyetësi për vlerësimin nga administrata për UMIB	Mars 2021	Po	ZSC, Koordinatorë t për cilësi, Stafi akademik, Studentët, Administrata,	Realizohen në Prill



UNIVERSITETI I MITROVICËS "ISA BOLETINI"
UNIVERSITY OF MITROVICA "ISA BOLETINI"

Nr.	Bartësi i Aktivitetit	Aktiviteti (Detyrat e planifikuara)	Periudha kohore	Implikimi financiar	Ndërlidhja	Të tjera
11	KQSCV	Pyetësi për vetëvlerësimin e stafit akademik. Pyetësi për vlerësimin nga Dekani për stafin akademik. Pyetësi për vlerësimin e studentëve Bachelor për stafin akademik dhe lëndët. Pyetësi për vlerësimin e studentëve Master për stafin akademik dhe lëndët.	Prill 2021	Po	ZSC, Dekanët, Koordinatorë t për cilësi, Stafi akademik, Studentët,	Realizohen në Maj 17.05.2021 - 31.05.2021
12	KQSCV	Pyetësi për vlerësimin nga ALUMNI. Pyetësi për vlerësimin nga palët e jashtme të interesit.	Qershor 2021	Po	ZSC, Koordinatorë t për cilësi, Njësitë akademike, Alumni, Palët e jashtme të interesit,	Realizohen në Korrik
13	KQSCV	Pyetësi për vetëvlerësimin e Dekanëve Pyetësi i vlerësimit të Dekanëve nga stafi akademik Pyetësi për vlerësimin e Dekanëve nga Rektori	Korrik 2021	Po	ZSC, Rektori, Dekanët, Koordinatorë t për cilësi, Stafi akademik	Realizohen në javën e parë të Shtatorit.
14	KQSCV	Plotësim - ndryshimi i paketës së instrumenteve për matjen e cilësisë	Shtator 2021	Po	ZSC	
15	KQSCV	Trajnime për ECTS me studentët	Dhjetor 2020 - Janar 2021	Po	ZSC, Njësitë akademike, Studentët	
16	KQSCV	Hartimi dhe rishikimi i rregulloreve dhe dokumenteve të tjera që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë në UMIB	Shtator - Tetor 2021	Po	ZSC, Njësitë akademike, Sekretari, ZLGJ	



UNIVERSITETI I MITROVICËS "ISA BOLETINI"
UNIVERSITY OF MITROVICA "ISA BOLETINI"

Nr.	Bartësi i Aktivitetit	Aktiviteti (Detyrat e planifikuara)	Periudha kohore	Implikimi financiar	Ndërlidhja	Të tjera
17	KQSCV	Trajnimi i anëtarëve të KQSCV nga organizata të ndryshme (Heras, WUS, etj), në lidhje me cilësinë, mësimdhënien, standardet e AKAs, etj.	Koha caktohet nga partnerët	Po	ZSC, Anëtarët e komisionit, Njësitë akademike	Varësisht prej kujt organizohet trajnimi mund dhe nuk mund të ketë implikime financiare
18	KQSCV	Shqyrtimi i rezultateve nga pyetësorët dhe nxjerrja e rekomandimeve për zhvillim të mëtutjeshëm	Çdo fund semestri/viti	Po	Senati, Rektorati, ZSC, Njësitë akademike, Studentit	

Plani i punës së komisionit është i një rëndësie shumë të madhe për mbarëvajtjen e punëve në institucionin tonë, meqë ky plan do të shërbejë si një udhërrëfyes mbi atë se nga do të lëvizim ne si komision në mënyrë që të mund të jemi gjithnjë në hap me trendet e zhvillimit të cilësisë në arsimin e lartë.

Ky plan pune do të kontribuojë drejt ngritjes së cilësisë në mësimdhënie, mësimnxënie dhe zhvillimin e një sistemi të mirëfilltë të cilësisë në kuadër të universitetit.

Prandaj, implementimi i këtij plani të punës shtrohet si një obligim për të gjithë akterët e përfshirë, për të punuar në përmbushjen dhe avancimin e misionit të universitetit, si dhe obligimeve që UMIB ka ndaj studentëve dhe qytetarëve të Kosovës për një arsim cilësor dhe me vlera. Nga data e miratimit të këtij dokumenti të gjitha aktivitetet zhvillimore të KQSCV, do të udhëhiqen nga ky dokument, i cili njëkohësisht do të jetë edhe tregues i performancës së komisionit.